

Show-Bizz

Përndiqte e sulmoi Luana Vjollcën, Besmir Lila: Më premtoi martesë



Lexime

08:25 - 14.04.17 | gsh.al



Xhensila KODRA

Jemi të dashuruar. Luana më ka premtuar se këto ditë do të martoheshim”. Kështu e ka nisur rrëfimin e tij në polici, 32-vjeçari Besmir Lila, i cili ka përfunduar në pranga me akuzën e përndjekjes ndaj moderatores së “Top Channel”, Luana Vjollca. I riu, i cili prej afro një viti i shkruante SMS me tekste të ndryshme pëlqimi e dashurie Luanës, 8 muajt e fundit kishte filluar ta ndiqte atë këmba-këmbës. Por vetëm dy ditë më parë, 32-vjeçari, banues në periferi të Tiranës, në fshatin Lundër, për pak sa nuk ka shkaktuar një ngjarje të rëndë kriminale. Prezantuesja e “Pa Limit” sapo kishte dalë nga puna dhe ishte duke shkuar për në shtëpi me makinën e saj tip “Audi”, kur kishte vënë re se po ndiqej nga një mjet “Fiat Punto” në të cilin ndodhej Lila. Duke qenë se ky i fundit i ka bërë shenjë që të ndalonte makinën, në atë moment Luana ka lajmëruar për situatën që po i krijohej, mikun e saj Krenar Çoçaj. Ky i fundit i ka shkuar menjëherë në ndihmë këngëtares Vjollca, ku po e ndiqte nga pas me makinën e tij për ndonjë rast rreziku. Për një moment, mjetet kanë ngecur në trafik në Unazën e Re dhe 32-vjeçari i ka shkuar “fiksimit” të tij në xhamin e makinës dhe i ka kërkuar ta takonte e të bisedonte me të. Për një moment, Lila ka nisur të bërtasë, kur nga pas ka marrë një grusht nga Krenar Çoçaj.

Dy djemtë kanë filluar të zihen me njëri-tjetrin me grushte e shkelma, duke përdorur edhe fjalë banale. Çoçaj i ka kërkuar 32-vjeçarit ta linte të qetë mikeshën e tij dhe të largohej prej saj, ndërsa ky i fundit, duke e ofenduar i kishte pohuar se e dashuronte. Lila e Çoçaj kanë marrë shenja të dukshme në fytyrë, ndërsa e gjithë skena ka ndodhur në sy të shumë kalimtarëve. Vetëm pak metra pas tyre ndodhej edhe një makinë policie e cila patrullonte në zonë. Uniformat blu u shkuan menjëherë në mbrojtje moderatores së njohur dhe mikut të saj, ndërsa ndërhyjnë për të shuar sherrin.

Por, kur Besmir Lila po nxirrte nga çanta një armë, është arrestuar menjëherë nga oficerët e policisë, të cilët bënë të mundur që sherrin në fjalë të mos përfundonte në ndonjë tragjedi. Menjëherë pas kësaj, Luana, Krenari dhe Besmiri janë shoqëruar në ambientet e Komisarariatit Nr. 6 në kryeqytet për t’u marrë në pyetje. 32-vjeçari akuzohet për veprat penale “Përndjekja”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” dhe “Dëmtime të tjera me dashje”. Ndërkaq, fiksimi që ai ka ndaj Luanës vihet re edhe në “Facebook”-un e tij, pasi janë të shumta videot dhe fotot që 32-vjeçari ka shpërndarë për të.


Dëshmitë

Burime pranë policisë thanë dje për “GSH” se që në fillim të dëshmisë, Besmir Lila ka rrëfyer se me Luanën ishte i dashuruar dhe kishte vendosur të bënte gjithçka për të. I riu ka treguar se ishte takuar më parë me moderatoren, duke pohuar se të dy kishin ndjenjë për njëri-tjetrin. 32-vjeçari ka mohuar faktin se e përndiqte prezantuesen, pasi shkuarjen e tij pas Luanës e konsideronte si një veprim që mund ta bëjë kushdo që është i dashuruar.

Ndërsa, moderatorja e njohur, e terrorizuar për situatën e krijuar, ka treguar se i riu e përndiqte prej 8 muajsh, por nuk e kishte denoncuar asnjëherë në polici. “Më bezdiste shpeshherë. Pothuajse kur shkoj e kur kthehem nga puna për në shtëpi. Nuk e kam denoncuar, sepse nuk i kam kushtuar shumë rëndësi”, – ka thënë në polici Luana. Kurse miku i saj, Krenar Çoçaj ka treguar se ishte njoftuar me telefon nga Luana se dikush po e ndiqte nga pas.

SHFAQ KOMENTET (0)

Të tjera në Show-Bizz



“Jam me fat që të kam”, Big Basta i dedikon fjalët më të ëmbla partneres

13:49 - 17.10.20 | gsh



Marina bëhet zyrtarisht ambasadore e markës së njohur: Jashtëzakonisht e lumtur

10:45 - 17.10.20 | gsh



Na la pa fjalë... Xhensila Myrteza bën tatuazhin më të veçantë për Ajkën

22:20 - 16.10.20 | Gazeta Shqiptare



“Haribo i babës”, Besniku pozon për herë të parë me Emin dhe sytë na bënë zemra

21:12 - 16.10.20 | Gazeta Shqiptare



E dashura e Ermal Metës ka ditëlindjen, këngëtari e prezanton publikisht me mesazhin romantik

18:10 - 16.10.20 | gsh



Probleme me policinë për Dua Lipën/ Theu rregullat e COVID, ndërpriten xhirimet

16:30 - 16.10.20 | gsh

GAZETA SHQIPTARE

www.gazetashqiptare.al

“Gazeta Shqiptare” është gazeta e pavarur më e vjetër në Shqipëri. E themeluar në 1927, publikimi i saj u ndërpre në 1939, me pushtimin fashist të Shqipërisë.

Email: gazetashqiptare.al@gmail.com
Marketing: marketing@gazetashqiptare.com
Kontakt: 0684063842
Financa : 0682074397
Marketing : 0688087323

Brenda

Aktualitet
Politike
Ekonomi
Media
Opinion-Komente
Shëndet

Tjera

Suplemente
Horoskopi
Shtypi i dites
Speciale
20 vite me pare

Focus Press

Kush jemi ne
Kontakt